


BIBLIOTEKA  
SHTETIT

8 Sh-1  
492



Rinore

*poetri*


Bashkim Hoxha

85h - 1  
H92

BASHKIM HOXHA

# Rinore

poezi



12628

12628

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## R R I T J E

Askush s'do dont'e tē ngelej tērē jetēn  
një fëmijë i vogël që e mëkojnë,  
ndryshe ç'kuptim do tē kishte shtati që na rritet  
dhe kraharori që zgjerohet?

Ndaj ndër aksione rendëm,  
në hekurudha,  
rrugë  
e kantiere,  
shtegëtim i bukur i rritjes sonë  
ku ne pohonim vetveten.

Sendeve nuk u mësuam vetëm nocionin  
mbi katedra, nëpër faqe librash.  
Me hap horizontet i përshkuam  
mes për mes stacioneve tē ditëve...

Duke punuar mësuam ç'do të thotë punë,  
duke u përleshur mësuam ç'do të thotë luftë  
klase.

Dhe e dimë mirë se buka nuk del nga furra,  
ajo nxirret nga balta . . .

## LUFTA E BREZIT TIM ME BORGJEZINË

Ne nuk e njohëm pronën private,  
as kambialet, pasuritë e palëvizshme,  
dyqanet private grumbulluar në faqet e shesheve  
si puçrra të bezdissishme.

Po ne mësuam se dhe një kufomë  
mund ta infektojë gjakun fare mirë,  
ndaj e luftojmë borgjezinë çdo çast, çdo orë  
me vigjilencë e me guxim.

Dhe nuk lëmë mjekër e flokë të gjatë,  
pyjeve nuk bredhim për të protestuar,  
ne dalim në sheshin e luftës me grushtin proletar  
drejt e nënofull për të qëlluar.

Përbaltemi për bukën, rendim në aksione  
dhe veshim rrrobën e gjelbër të ushtrisë,  
me fletërrufetë që përflakin sheshet,  
patericën e fundit i heqim borgjezisë.

## KËRKESË PËR JETËN

Ç'kuptim do të kishte  
të qëndroja shtrirë tërë ditën  
e mendimet boshe,  
si re karkalecash,  
të uleshin në brazdat e trurit tim,  
të dremisja i plogësht pranë zjarrit  
duke ëndërruar si diçka abstrakte lumturinë?

Unë lëviz tërë ditën në mes njerëzve,  
marr frymë bashkë me ta,  
gjallërohem nga frymëmarrja e përbashkët,  
përpjek kilometra jete pa mbarim,  
kilometra që rëndojnë nga ngjarjet.

Dhe ndodh tërë natën rri zgjuar mbi letra,  
tëmthat gjer në dhembje i shtrëngoj,  
atëherë unë shijoj një lumturi konkrete  
dhe nga pantoflat e Obllomovit distancën zgjatoj...

## 20 V J E Ç

Nata është e qetë, nata është e butë.  
Qetësia është shtrirë gjatë e gjerë  
në të gjitha rrugët.

Digjen llambat  
si i vetmi mendim  
në një tru të qetë,  
që fle.  
Po si mundesh, vallë,  
njëzetvjeçar  
i qetë të jesh sa s'ka më?!

Në trurin tim kalon plugu i kohës  
dhe rriten èndërrat si fije bari,  
si kallinj gruri piqen mendimet...

Si mundesh, vallë, të jesh i qetë  
kur ndien të rritet jeta me kërcitje?

Ditën që mbush njëzet vjet  
je si bujku në ditët e para të pranverës.

## DITË TË NGROHTA

Çdo njeri ka ëndërra të bukura  
që kërkojnë të ngjiten në lartësi,  
socializmi është qelli i madh i kaltër  
ku ato marrin fluturim.

Dëshirat e fuqishme çdo njeri  
me dashurinë e vet përditë i ushqen,  
socializmi është stina më e ngrohtë  
ku gjelbërimi i zemrës zë shpërthen.

## NËNA E DËSHMORIT

C'kërkonte mbrëmë nëna e dëshmorit,  
ç'kërkonte mbrëmë në sytë e mi?  
Ajo më përqafonte dhe heshtte  
pa më thënë se i ngjaja të birit.

Ishte nata e parë e pranverës,  
në qìell hëna u shfaq e kuqe;  
unë ndjeva papritur se vetëm për një natë  
mund të mbushen gjithë pemët me lule.

Dhe për një natë mund të ndiesh kaq pranë  
të kaluarën dhe përjetësinë,  
veten më mirë mund ta kuptosh,  
ç'kërkohet prej teje mund ta kuptosh më mirë.

\* \* \*

Fëshfërima e kalemit mbi letër  
merr forma të ndryshme në mendimet e mia.  
Herë-herë më duket si fëshfërima e gurit kur fryn  
erë,  
herë-herë si fëshfërima e një xhakaventoje blu,  
sikur fërkohet deti me brigjet më duket herë-herë.

Ndonjëherë më duket se dikush po vdes,  
ose, në të kundërtën,  
ndiej frymëmarrjen e një fëmije që fle.

Po, kur dëgjoj zvarritjen e hapave pa qëllim në  
trotuar,  
e di —  
janë vargjet që nuk thonë asgjë.

## VJERSHA IME PËR FSHATIN

Kur shkoj në fshat dhe fshatarët  
më shtrëngojnë dorën me duart e tyre si plisa dheu,  
unë mendoj se duhet të them diçka për ta,  
qoftë për respektin që kemi ndaj bukës,  
qoftë dhe për djersën e tyre të ndershme.

Dhe dua t'i njoh më mirë, patjetër t'i njoh,  
duke u përbaltur më shumë përkrah tyre,  
dhe të bëj një vjershë të mirë për ta,  
të dobishme si gruri i fushës.

## KËNGË PËR LULIN, MËSUESEN E FSHATIT

Ti e deshe shumë qytetin e lindjes,  
dhjetra këngë dashurie për të thure;  
po ç'kuptim do të kishte, ç'kuptim  
nëse pranvera do të çelte vetëm një lule?

Ti thure këngë për qytetin e lindjes,  
për detin, erërat, njerëzit që doje;  
tani në një udhë të largët dimërore  
fëmijët të presin mes dëborës.

Dhe e lumtur ndihesh sërish  
në atë fshat të largët, diku në veri,  
jeta është më shumë se një qytet,  
dhe nuk jetohet vetëm për një dashuri.

## R R U G Ë T

Të kam thënë se nuk më pëlqejnë rrugët me baltë,  
të bëhem me baltë në rrugët me baltë,  
të shëtis me çizme në rrugët me baltë,  
të kam thënë se nuk më pëlqen.

Dhe ja, prej meje more telegramin  
«U nisa në x-fshat».  
U nisa, mos u çudit,  
duhet t'i shtrojmë gjithë rrugët me asfalt.

## S H O K È

Ku janë sot shokët e maturës,  
bisedat e shqetësuara në mesnatë, ku janë?  
Dhjetra mendime drejt ëndrrash të ngrohta  
si zogj shtegëtarë nisnim varg....

Tani njëri është larg në jug,  
tjetri është larg në veri;  
në gjeografinë socialiste të atdheut  
zgjaten rrugët e rinisë.

Çfarë shkruam dikur në hartime,  
sot hedh shtat, rritet në jetë,  
janë shkundur petalet e bardha naive  
dhe të pjekura kokrrat mbeten.

## UNË DHE SHOKU IM SKULPTOR

Ka shumë vajza të bukura në vendin tim  
që nëpër aksione gjithmonë i gjen;  
ka shumë djem të pashëm e të fuqishëm,  
socializmi në dejet e tyre zien.

Ka pleq mollzanxjerrë që mblidhen në festa,  
që kanë bërë Luftën, dhe bij të bukur;  
ka nëna të dhembshura,  
që vazhdimisht ruajnë nga një pikë lot  
për ndarjet, takimet,  
çastet e lumtura.

Rinia dhe burrëria nuk duhen lënë të ikin,  
pleqëria dhe dhembshuria nuk duhen lënë të vdesin,  
në vendin tim kanë shumë punë skulptorët,  
në vendin tim kanë shumë punë poetët...

## E P I K E

Gjyshërit e mi kanë qenë njerëz të ndershëm,  
gjyshërit e mi kanë qenë njerëz të mirë,  
ata në shekuj e deshën tokën  
siç deshën fëmijët.

Këngët e tyre mund të ishin të qeta si fëmijët,  
të buta si frymëmarrja e tokës mund të ishin vallet,  
por ëndërrat e tyre zgjoheshin  
nga trokthe kuajsh në mes të natës.

Dhe tingujt dilnin si kushtrim  
dhe rreptë në valle i lëviznin kokat,  
kështu në shekuj lindi arti ynë epik  
i kushtëzuar nga epokat.



## DUKE DËGJUAR NJË KËNGË TË HARRUAR PËR KURBETIN

Pemët që rriten kënetave  
frutat të hidhura i kanë,  
këngët e lagura nga dhembja  
të hidhura janë...

Dëgjo këtë këngë dhe do të ndiesh  
se si përpëlitet një zemër që vuan  
me shpresën e vetme dërguar diku larg  
në dhera të huaj.

Këngë e kurbetit,  
këngë e harruar!

Duke u ngritur kështu si nga një gjumë letargjik,  
na bëre të mendojmë për dhembjen që shkuam  
dhe gëzimin e sotëm ta ndiejmë më mirë.



## KUR U VAR KOMITI

*Motiv i vjetër*

Koka pranë degëve,  
trim komit i maleve,  
këmbët pranë luleve,  
trim komit i maleve.

Era trupin e tij tund  
majtas-djathtas. Dhe ai  
dhe i vdekur vallen hedh,  
mban një gjethe si shami.

## HISTORIA

*Bismarku thoshte se Shqipëria  
është vetëm një shprehje gjeo-  
grafike.*

Në dhjetra gjuhë kanë folur Bismarkët nga konferenca pajeje e nga traktate të fshehtë, ndërsa populli im në truallin e tij vazhdonte ciklin që quhet jetë.

Punë, luftë, këngë, dashuri, gjumë dhe ëndërra të bukura për të nesërmën... Bismarkun e fusin në botime luksi pas kopertina kadifeje.

Populli im i përtërirë e i rilindur përmes brezave rrugë në histori i hapi vetes, ndërsa veshur nga gria e pluhurit ngeli Bismarku, burgosur në raftet e bibliotekës.

Përditë historinë e tyre shkruajnë popujt,  
pavarësisht nga profecira Bismarkësh,  
nuk është jeta tragjedi e lashtë,  
fatet e botës s'i përcaktojnë orakujt!

## DIMRI I PERANDORIT

*Vasil Laçi*

Atë ditë ti vije rëndë-rëndë  
me një ballon brenda vetes  
fryrë me iluzione . . .

Të ftohta qenë malet.  
Nga bora, mendove.  
Të ftohta qenë fushat.  
Nga era, the.  
Të ftohtë qenë njerëzit.  
Nga se,  
nga se?

Plumbi i Vasilit s'të preku dot' në zemër,  
por ballonin e iluzioneve të një perandorie e shfryu  
dhe ti në sapoardhje mendove ikjen  
nga këmbët sytë.

Të ftohta qenë malet.  
Nga bora, mendove.  
Të ftohta qenë fushat.  
Nga era, the.  
Të ftohtë qenë njerëzit  
Nga se,  
nga se?

Në rrugët e ngushta të një vendi të vogël  
perandoria  
njoju dimrin e vet.

## SHOQJA JONË E LUFTËS

*Për Liri Geron shokët e saj thonë  
se ishte një vajzë tëndërrimtare...*

Ka pranvera lule shumë,  
kanë lumenjtë gurgullima,  
ka në qiel qogj pa numër,  
kanë njerëzit tëndërra shumë,

Liri Gero, o moj trime.

Është një moment i vetëm në prag të lindjes së  
diellit,  
një moment i vetëm në ngjyrë jargavani,  
kur dëgjon zërat e jetës të mbledhura në një  
pikë  
që i përket edhe ditës dhe natës.

Atëherë të lind dëshira të bësh gjëra të  
bukura,  
përtej kufirit të pamundësisë të shkosh,

të lind dëshira të qeshësh, të thurësh këngë,  
të ndjekësh fluturat dhe xixëllonjat.

Kërkon të bësh diçka për njerëzit,  
diçka që nuk e bëre në ditën që iku,  
po që mund ta bësh në ditën që do zbardhë...

Nisi ëndrrat ngado fluturim,  
në qiellin e madh të kohës le t'u rriten krahët  
edhe nëse qielli vjen erë baruti,  
edhe nëse kur pinë ujë burimeve në buzë u  
ngrin gjaku,

edhe nëse lufta egër të troket në derë  
jo si një baloz i largët përralle,  
po me një kondak dyfeku që të godet në trup  
dhe një tytë që kërkon në zemër rrahjet,

dhe një shkelje me këpucë me thumba në  
trupin tënd,  
dhe një masakrim në trupin e popullit tënd,  
dhe një tharje bari e lulesh mbi dheun tënd,  
dhe një grumbull zjarresh në syrin tënd.

Nisi ëndërrat ngado fluturim,  
në qiellin e turbullt të kohës le t'u rriten  
krahët;

hapësirat e ditëve që do vijnë ato do mbushin  
me cicërima  
edhe rënduar nga baruti, edhe përzhitur nga  
flakët.

Nisi ëndërrat ngado fluturim  
në horizontin që sheh dhe përtej vijës së  
horizontit,  
ai që kurrë nuk ëndërroi gjérat e largëta,  
edhe gjérat e afërtë t'i kuptonte s'qe i zoti.

Ëndërrro për ditët e reja  
duke jetuar ditët e rënda të Luftës,  
kjo është më e vështira se të gjitha,  
më e madhërishmja, njerëzorja, e bukurë.

Ka pranvera lule shumë,  
kanë lumenjtë gurgullima,  
ka në qiel qogj pa numër,  
kanë njerëzit ëndërra shumë,  
Liri Gero, o moj trime.

flotigib ës orja qarr zët dalv zomt ës e ës  
çiturasb lejtës nindianolox ët  
fëgħiex ës is-sorġqadha t' i farisħn u  
... sħidha kuraġġi i lejnha kif

R R E T H I M I

Njerézit jané tē qetë, jashtëzakonisht tē qetë,  
aq sa tē duket e pabesuveshme fjala rrethim (A  
(si një gjembaç i egér që gabimisht ka celur  
mes barit tē butë jeshil).

Njerézit hipin dhe zbresin nga urbanet,  
bējnë kozmetikë, mësojnë këngë tē reja,  
ndërsa fjala rrethim nënkuption tanke nëpér  
dhe rrékezat e gjakut nē fytyrë tē rrjedhin.

dhe ti t'i lidħeš flokët me dy fjongo tē kuqe  
dhe tē vesh një kapele siper tyre,  
dhe tē veshħeš një uniforme ushtarësh patjetér  
pér tē mos qenë e tgħadalt nē luftë.

dhe tē mos vish tek unë sapo tē dëgjosh  
tē zakonshmin sinjal dashurie, .  
po èndërrat t'i kreshpéroje si era dallgët  
një sinjal i zgjatur borie...:

Megjithatë rrëthimi është  
i egër dhe real pranë nesh përditë,  
nuk ka nevojë tē kërcasin bombat,  
nuk ka nevojë tē ngjiren boritë.

Atë e ndiejnë jo vetëm brigjet,  
atë e ndien jo vetëm buzë kufirit,  
në qoftë se gjoksin i ke vënë kohës,  
çdo çast kudo tē është i pranishëm...

Në qoftë se shqetësohesh për socializmin  
si për një fëmijë tē dashur, atë e ndien  
se si tē hyn në dhomë si një korent ajri  
sapo tē hapësh pak dritaren ...

Dhe tē shefi burokrat, ai është trupëzuar,  
rrëthimi është dhe tek izmat e moda,  
duke marrë fjalën në luftën klasore,  
ke shkrepur breshëri e mijra bomba,

ke nxjerrë tanket nëpër rrugë  
dhe ke shpallur mobilizimin e ushtrisë  
edhe duke qenë i qetë këtë pasdite,  
edhe pse të duket e pabesueshme fjala rrëthim.

## **DUHET TË ËNDËRROJMË**

Kur revolucioni këmbëzbathur çante akullin e rrugëve të vjetra të Petërburgut dhe zhele-zhele bërë nga baruti hynte në Pallatin e Dimrit, kur thërrimet e bukës ishin për t'u vënë në unaza, jo brilantet,  
«Duhet të ëndërrojmë»,

— tha Lenini.

Dhe papritur këmbët e zbathura shkelën mbi parkete dhe zhelet u kthyen në kostume të hekurosura më së miri, thërrimet e bukës u kthyen në fara gruri që mbollën hapësirat e mëdha të pafundme kur «Duhet të ëndërrojmë»,  
— tha Lenini.

Dhe më e qartë u bë dita e sotme dhe e nesërme,  
dhe të gjithë e kuptuan se revolucionin  
e bëjnë njerëz prej mishi e gjaku, prej gëzimi dhe  
loti  
që dinë të luftojnë e të ëndërrojnë.

Po Lenini nuk tha t'ia këpusnin gjumit  
në rrugët e acarta të dimrit,  
ai që e bëri këtë gjë, në mëngjes u gdhi  
me qarkullimin e gjakut komunist, të ngrirë.

Të ëndërrosh, sipas Leninit, do të thotë të jetosh  
të sotmen  
dhe pa mbyllur sy, në ato që sheh përditë, të  
ndiesh të nesërmen,

për ta transformuar sipas dialektikës  
me kurajë, vullnet, dashuri dhe djersë të ndershme.

## NJË MIJË KËNGË DHE NJË VJERSHË

Një mijë këngë jam gati të bëj për heronjtë  
që dëshirat e mëdha të secilit trazojnë si era  
prushin,  
i takojmë çdo çast, çdo orë  
në të njëmijë rrugët.

Një mijë këngë jam gati të bëj për punëtorët  
që shpatullat kanë vënë në themel të shtetit...

Një mijë këngë jam gati të bëj për socializmin e  
rininë time,  
përëndrrat e pastra e të ndershme  
që na bëjnë të kuptojmë ekzistencën  
dhe rrugët e shumta të jetës.

Një mijë këngë jam gati të bëj pér dashurinë  
që na bën të përgjysmojmë kohën e të dyfishtojmë  
hapësirën  
dhe do të ndihem i kënaqur si bredhat  
që nuk njohin kurrë dimër.

Por po bëj një vjershë kundër burokracisë.  
Kur flas kundër saj, unë i kam pohuar të gjitha,  
që nga mendimet majlarta pér shtetin proletar  
deri te gjërat e përditshme si dashuria.

31. Një burokrat i cili nuk ka qarri që është  
një burokrat është o një burokrat që nuk ka qarri që

32. Një burokrat është që nuk ka qarri që është  
një burokrat që nuk ka qarri që

## C'I THA NJË BUROKRATI KRÝETARI I GRUPIT TË KONTROLLIT PUNËTOR

Kur përbysëm pushtetin e vjetër,  
përbysëm burokracinë e tij.

ne ndiemë se po ndërtonim diçka tjetër,  
diçka që s'e patëm më parë.

Konstruktua makinën e re të shtetit  
si një lokomotivë plot vrull, energji  
dhe ajo i tërroqi punët përparrë  
dhe i tërheq për bukurin.

Dhe vumë në të nëpunësit tanë  
të bënin detyrën e fugistit,  
në furrën e madhe pa pushim  
qymyrin me lopatë të hidhnin.

Dhe të gjithë bashkë e secili veç e veç  
detyrën tonë të përbashkët kryejmë  
për të arritur atje për ku u nisëm  
që në fillim të luftës.

Dhe nuk do të lejojmë që një mëngjes  
papritur

të gdhihem bllokuar s'di se si,  
ngaqë dikush qymyrin e përbashkët  
e hedh në sobën e interesit të tij.

Kur përmbysem pushtetin e vjetër,  
përmbysem burokracinë e tij.  
Dhe duhet kuptuar se ndërtuan diçka tjetër,  
diçka që s'ka qenë kurrë më parë.

## V A Z H D I M Ë S I

Në qoftë se dje nuk kishim asgjë  
dhe sot i kemi të gjitha që nga komforti i shtëpisë  
e deri te pushteti,  
kjo nuk do të thotë, kurrsesi nuk do të thotë,  
se erdhi koha të bëhemë të qetë.

Bukuri.

Po kjo nuk do të thotë se revolucionin e mbaruam,  
kjo nuk do të thotë kurrsesi.

Kjo nuk do të thotë se llogoret i bëmë pistë  
vallëzimi  
dhe se gjakun e bëmë rubin për të zbuluar  
unazat,  
kjo nuk do të thotë të rrahim gjoksin për ç'ka bëmë.

Kjo nuk do të thotë se revolucionin e mbaruam,  
nuk do të thotë kurrsesi,  
kjo do të thotë se duhet të bëjmë shumë  
që zemra të na rrahë gjithmonë partizane  
dhe të ruajmë të pastër gjakun komunist.

## КОМУНИСТ

Башти ја барај се јединство народу и земји за  
зголемување на земјата и развој на народот.  
Башти ја барај се јединство народу и земји за  
зголемување на земјата и развој на народот.

Башти ја барај се јединство народу и земји за  
зголемување на земјата и развој на народот.

Башти ја барај се јединство народу и земји за  
зголемување на земјата и развој на народот.  
Башти ја барај се јединство народу и земји за  
зголемување на земјата и развој на народот.

Башти ја барај се јединство народу и земји за  
зголемување на земјата и развој на народот.  
Башти ја барај се јединство народу и земји за  
зголемување на земјата и развој на народот.

... i këndet e njohurit, ob Stori i ob zan ojz  
... i këndet e njohurit, ob Stori i ob zan  
... i këndet e njohurit, ob Stori i ob ojz  
... i këndet e njohurit, ob Stori i ob ojz

## K O M U N I S T È T

Të jesh i pari që në fillim të ditës e deri në fund  
të natës,  
të jesh i pari që nga mbledhjet, pagjumësia, halli e  
kënga,  
të jesh komunist, është detyrë e vështirë,  
ndoshta më e rënda.

Por ju nuk zgjodhët rrugë të lehta,  
ndryshe nuk do të bëheshin kaq shumë gjëra,  
nuk do të ngriheshin kaq shumë gjëra të reja  
që nga pushteti deri te kënga.

Dhe kur ndonjë ka dashur mbi teserën të hipë  
si mbi një qilim fluturues për të arritur diku,  
ju i keni treguar se nuk mund të shkelet me  
këmbë,  
si mbi qilim,  
mbi flamur.

## P A R T I A

Ka vite, që kur nisa të njoh botën,  
një këngë dua të këndoja,  
ka vite që matem të shkruaj  
dhe nuk them dot gjë për Partinë.  
Nuk dua të ngrihem mbi ballonat e fjalëve,  
jetën për të në heشتje jap më mirë.

Dhe sot një këngë marr guximin të ngre,  
vetëm duke u mbështetur te të gjithë ju.  
Në pëauzat midis dy vargjeve të dashurisë sime  
secili të vendosë dashurinë e tij të pafund.

Partia —  
dashuria më e madhe,  
dashuria që u jep jetë gjithë dashurive.  
Është dielli që ngroh rininë tonë  
dhe i jep asaj klorofilin.

(Po të krahasoj Partinë me diellin,  
të gjithë do të thonë, e kanë bërë këtë gjë të tjerë,  
po kjo do të thotë se është e vërtetë  
dhe e përgjithshme për ne të gjithë.

Partia —

një komb të tërë e ngriti më këmbë,  
përtériu zemrën e plakut njëqindeca vjeçar  
dhe buzët e tij të thara i bëri fyell për t'i kënduar  
jetës,  
përtériu vogëlushët,  
të gjithë njerëzit i burroi dhe i rinoi  
njëkohësisht,  
i bëri të ndiejnë gëzimin e të gjitha stinëve.

Ka njëzet vjet që dua të them diçka për Partinë  
dhe nuk e di në jam i zoti ta bëj këtë gjë.  
Këtë këngë mora guximin ta ngre vetëm duke  
**besuar**  
se në pauzat midis rreshtave  
secili do të vendosë dashurinë e tij për Të.

## KUNDËR REFORMISTËVE

Thellë e më thellë në kënetë zhyten  
qerret e shteteve e qeverive.

— Reforma! Reforma!, — dëgjohen thirrje. —  
Ato e lëvizin historinë!

Dhe vijnë Rosinantët kockë e lëkurë,  
reformistë gjithfarësh vijnë;  
lidhen pas asaj që zhytet  
thellë e më thellë në baltovinë.

Kuaj gërdallë reformat;  
për të çuar përpara netët dhe ditët,  
duhen buldozerë mijëra kuajsh fuqi...  
Revolucioni vetëm tërheq historinë!

## NJË BOTË QË VDES

Në Manhatan, Uollstrit, Moskë, në ekzotikën  
japoneze,  
nëpër rrugët me drita që skuqin si sytë në ethe,  
pas zhurmë supersonikësh, sensasionesh, najt'  
klubesh  
rënkon një botë duke vdekur.

Te këto shëndritje reklamash  
janë purpuri i plagëve të saj mbushur me qelb,  
llomotitjet dekadente për fundin e botës,  
kllapitë e një bote që po vdes.

Mbërthyer nga kriza, nga dhembje mishrash,  
në qelbzim plagësh duke vdekur, një botë e  
vjetër rënkon.  
Ndërsa nga frysma marrja e revolucionit zgjerohet  
i shëndetshëm kraharori i kohës sonë.

## BISEDË ME NJË SHOK PROLETAR PËR LUFTËN KUNDËR BORGJEZISË

\* \* \*

Unë nuk u besoj pëllumbave të tyre të bardhë,  
ata mund ta ndyjnë fare mirë kostumin ditën e  
diel në lulishte.

Nuk u besoj më fjalëve, konferencave,  
ato janë si gjethet e rrushit  
për të fshehur më kot diçka lakuriqe.

Nga flamurët e bardhë të kapitullimit të merren  
sytë,  
siç të merren sytë nga bardhësia e pafund e  
dëborës . . .

\* \* \*

Vër veshin në qetësinë e natës.

Përpiqu të dëgjosh përtej diplomacisë së fjalëve të  
bukura.

Vërshimi i lumenjve në stinën e shirave është më  
i qetë,  
zhurmërima e rrënjeve në pranverë është më e  
butë.

Në dhjetëra mënyra përpiken të na vrasin,  
organizojnë luftën kundër meje dhe teje,  
përpiku këtë gjë ta kuptosh ...

\* \* \*

Përderisa ty përpiken të të vrasin fshehurazi  
dhe përderisa këtë gjë ne e dimë fare mirë,  
flake tej gjethen e rrushit, le ta rrëzojë vjeshta  
dhe ta deklarojmë gjithçka botërisht.

Dil hapur ballë për ballë,  
merr në shënjestër sytë, hundën, buzët.  
Një mijë herë më mirë kërcitja e plumbit në kafkë,  
se helmi në vesh apo mbytja nga puthjet.

\* \* \*

Nuk e duam luftën.  
E duam qetësinë e mëngjeseve dhe këngën e  
bilbilave.  
Më ke parë sa i ëmbël, sa i dashur  
jam me njerëzit e mi në gëzime? ...

E duam paqen, por të ndershme,  
se ndryshe do të na vinte turp për të përditë.  
Do të na dukej sikur hanim drekë edhe darkë  
bukë të grabitur.

Ndaj luftojmë për të, luftojmë,  
asgjë absurde nuk ka në këtë fjalë,  
është njësoj si të thuash se një fëmijë i bukur  
vjen përmes shëmtimit të nënës nga barra.

\* \* \*

Përderisa ty përpiken të të vrasin fshehurazi  
dhe përderisa ne këtë gjë e dimë fare mirë,  
flake tej gjethen e rrushit, le ta rrëzojë vjeshta  
dhe ta deklarojmë gjithçka botërisht.

Copën e kuqe të toreadorit  
mos ki frikë t'ua shpalosësh para syve demave  
dhe këtë ti di ta bësh fare mirë,  
përderisa ke mbetur i ndershëm.

## P O E Z I A

Unë nuk dua të jem vetëm me vargjet e mia  
si udhëtari me hijen e vetes në shkretëtirë,  
unë eci në jetë duke kënduar në korin e klasës  
ku secili ka zërin e tij.

Po të mos ishte kështu, kënga ime do endej,  
do endej

e së fundi do vdiste  
nga lodhja, mërzia dhe etja.

Unë e kuptoj:  
do të kem vlerë gjersa të jem i përgjithshëm  
duke qenë njëkohësisht i përveçëm...

## N Ë P Ë R   R R U G Ë

Kam ecur dhe eci shumë nëpër rrugë,  
nga jugu në veri, nga veriu në jugë.

Shpeshherë ekuinokset e stinëvë apo ndërrimet e  
viteve  
më kanë gjetur nëpër rrugë.

Rend të takoj punëtorët, të qëndroj me ta,  
të ndiej erën e djersës dhe kënaqësinë e larjes pas  
punës,  
të ndiej si jeta lëviz në çdo çast  
duke të rrëshqitur para syve, nëpër duar.

Të ndiesh lëvizjen e njerëzve drejt dashurisë,  
të shqetësoshesh për hallet dhe gëzimet e tyre,  
është njëlloj si të shfletosh dhjetëra libra,  
se të fantazosh tërë jetën është më shumë...

## E ARDHMJJA IME PA ZËRA PROFETËSH

Duke shembur minare xhamish,  
sakatosjen e artit nëpër ikona duke pështyrë,  
unë veten e ndiej më të lirë.

Nga zérat e priftërinjve kur iki,  
me logjikën naive të fesë kur tallem,  
unë veten e ndiej më të rritur.

Dhe nuk përbys kupën e qiellit si filxhan  
pas ravijëzimesh, resh dhe yjesh  
të ardhmen time për të parë.  
Unë atë e shoh vetëm te duart  
(jo te vijat),  
te kallot.

Partia horizontet m'i ka bërë të qarta,  
besimin mbështes mbi shpatullat e klasës.  
Mjekra profetësh s'më mjegullojnë të ardhmen,  
horizontet nuk thyhen në xhame altarësh.

Durrës 1967-1977

## BISEDË NGA TUNELI I DEVIJIMIT TË DRINIT

Ti nuk e di se është dhe ky tunel buzë Drinit  
ku gjëmojnë pistolelat e betonierat me zhurmë.  
Këtu dhe dita dhe nata bëhen ditë,  
si nëpër dasma nuk ka gjumë.

Ti tani fle dhe nuk e di  
se zgjuar me punëtorët jam dhe unë.  
Unë vetë kam kërkuar: le të shoh më pak  
ëndrra,  
vetëm realisht të jetoj më shumë . . .

## D Ë S H I R Ë

Dua tē vijnë sot punëtorët që njoha kudo  
tē pagjumë e gizmeperbaltur;  
në këtë libër tē hyjnë pa trokitur,  
kanatet e vjershavë janë hapur.

Dhe po tē mos jenë tē pranishëm në çdo varg,  
unë do t'i gris këpucët kantiereve, maleve rrugëve,  
gjersa nëpërmjet vargjeve tē ndihetjeta  
si frymëmarrja jonë nëpërmjet buzëve.

## F È M I J È T

Ti mund t  jesh i lodhur e i pagjum ,  
sapo je kthyer nga zbori apo nga betonimi,  
ata t  afrohen leht -leht .  
me shqet simet e tyre naive.

Dhe nga peisazhi i lodhjes zhduk  pagjum sia  
dhe zbresin tone t  buta lirike.  
F mij t enden si pul bardha  
mbi detin e shqet simeve t  t  rriturve...

## MBRESA NGA NJË SHËRBIM TE DETARËT

Për një detar nuk pyesin sa vjeç është,  
nuk pyesin se në cilin vit ka lindur,  
as se në cilin vit ka vdekur nuk pyesin kurrë.  
Me zëra të qetë si murmurima dallgësh   në  
  muzg  
ata pyesin vetëm sa furtuna ka kaluar...

Ndoshta kështu duhet pyetur për   të gjithë  
  njëzet.

## PESHKATARËT E VJETËR

Ata hedhin grepat e tani presin  
duke sjellë ndër mend dhjetra ngjarje,  
dhjetra kujtime si peshq të artë  
tërheqin bashkë me tonjat përmes valëve.

Tërë jetën në det menduan për brigjet,  
tani në tokë për detin mendojnë;  
jeta e tyre si në ekuinoksin e stinëve  
qëndron midis detit dhe tokës.

Dhe ata e dinë, tek qëndrojnë ashtu  
si shkëmbinj buzë detit duke pritur,  
askush s'i desh brigjet se ta më shumë,  
askush më shumë se ta në detra nuk pat ikur.

## DETARI PLAK KUR U NDA NGA DETI

I kishte sytë të zinj detari plak,  
sa keq që s'i kishte të kaltër,  
ndryshe atë ditë që dilte në pension  
ç'do merrte si kujtim nga deti vallë?

Në mollëzat e tij si në brigje shkëmbore  
të rrahura nga dielli dhe kripa  
erërat e ndarjes, që trazonin zemrat,  
stërkala lotësh sillnin.

Ai kishte gjithë detin brenda tij...

## D U R R Ě S

Ti më flet me gjuhën e valëve dhe unë të kuptoj,  
më flet me gjuhën e diellit dhe unë të kuptoj,  
më flet me gjuhën e erës dhe unë sërish të kuptoj,  
megjithëse nuk thua asnje fjälë.

Më flasin kështu rrugët, shtëpitë, sirenat,  
lashtësia jote më flet nga thellësitë  
e shfaqur në fytyrat me kozmetikë balte të muzeut,  
e fshehur nën tokë me një mozaik.

Gjuhën tënde unë e njoh fare mirë,  
se ty të kam të tèrin thellë brenda vetes,  
unë jam përjetësisht i lidhur me ty  
si pulëbardhat me detin.

## A R K E O L O G U

Te kömbët e tua amfiteatri.

C'tragjedi e lashtë luhet aty,  
ç'personazhe lëvizin,  
monologje të gjata mijëra vjetësh  
në heshtje duke recituar?

Ti gërmont dheun dhe hyn që lart  
si një «deus ex machina» i vonuar.

## RESTAURIMI I KALASË SË DURRËSIT

Nëpër shekuj qëndroi më këmbë kjo kala  
duke sfiduar zemërime perandorësh,  
kaluan rrebeshe, lanë firmat e tyre  
në gurët e shembur nga topat.

Transplatimin e lëkurës së gurtë  
bëjnë tanë punëtorët,  
me gurë të marrë nga koha jonë  
sikur kërkojnë të lidhin epokat.

## NJË KËNGË PËR DASHURINË

Njerëzit kanë ardhur në botë dhe kanë ikur,  
po dashuria ka mbetur  
jo në muzeume e faqe librash,  
e gjallë brenda njerëzve.

Te njerëzit e thjeshtë, te heronjtë e legjendave  
dhe në rrënojat e luftërave ngrihet ajo madhërisht.  
Përzihej me para, interesa, mbretër, hidalgo,  
po prapë te ne vjen e pastër çuditërisht.

Vjen deri në kohën tonë, te kjo mbrëmje vjeshte,  
te kjo rrugë me gjethë të zverdhura bukur,  
te kjo përcjellje e një dite për të ardhur dita tjetër,  
me shqetësimë të njëjta, me shqetësimë të  
ndryshme.

Mbi dhjetra probleme, mbi dhjetra shqetësimë që veç e veç kemi dhe të dy bashkë, unë dhe ti, si zog i brishtë mbi një tel të zhurmshëm telefoni dashuria jonë e madhe rri.

Në qetësinë e luadheve prej bari,  
në zhurmërimën e punës përherë ajo  
është pleksja e emrave tanë  
me kohën që jetojmë...

## TË SHTUNËN PASDITE

Unë të prisja ty si zakonisht.

Askush nuk e vinte re se ti mungoje atë pasdite.

Pastaj ti erdhe.

Dëbora nuk ishte më dëborë, —

pëllumbë të bardhë qenë ulur mbi degët e bredhave  
atë të shtunë pasdite.

## PASQYRA E LËNDES

Faqe

Rritje .....	3
Lufta e brezit tim me borgjezinë .....	5
Kërkesë për jetën .....	6
20 vjeç .....	7
Ditë të ngrohta .....	9
Nëna e dëshmorit .....	10
Fëshfërima e kalemit mbi letër .....	11
Vjersha ime për fshatin .....	12
Këngë për Lulin, mësuesen e fshatit .....	13
Rrugët .....	14
Shokë .....	15
Unë dhe shoku im skulptor .....	16
Epike .....	17
Duke dëgjuar një këngë të harruar për kurbetin .....	18
Kur u var komiti .....	19
Historia .....	20
Dimri i perandorit .....	22
Shoqja jonë e luftës .....	24
Rrethimi .....	27
Duhet të ëndërrojmë .....	30
Një mijë këngë dhe një vjershë .....	32
Ç'i tha një burokrati kryetari i grupit të kontrollit	

punëtor	34
Vazhdimësi	36
Komunistët	38
Partia	39
Kundër reformistëve	41
Një botë që vdes	42
Bisedë me një shok proletar për luftën kundër borgjezisë	43
Poezia	46
Nëpër rrugë	47
E ardhmja ime pa zëra profetësh	48
Bisedë nga tuneli i devijimit të Drinit	49
Dëshirë	50
Mbresa nga një shërbim te detarët	52
Peshkatarët e vjetër	53
Detari plak kur u nda nga deti	54
Durrës	55
Arkeologu	56
Restaurimi i Kalasë së Durrësit	57
Një këngë për dashurinë	58
Të shtunën pasdite	60

Tirazhi 1500 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

---

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re

Tiranë, 1977